

DËFTESË E SIGURISË TEKNIKE



Data e botimit/Data e ndryshimit : 27 Dhjetor 2018 Versioni : 3.04

SEKSIONI 1: Identifikim i lëndës/përgatesës dhe i kompanisë/ndërmarrjes

1.1 Identifikuesi i produktit

Emri i produktit : SIGMAFAST 210 HS HARDENER
Kodi i produktit : 00383320
Mjete të tjera identifikuese : Nuk zotërohet.

1.2 Përdorime përkatëse të identifikuara të lëndës ose të përzierjes dhe përdorime që nuk këshillohen

Përdorimi i produktit : Aplikime profesionale, Përdoret me spërkatje.
**Përdorimi i lëndës/
përgatesës** : Veshje.

1.3 Hollësi për ofruesin e dëftesës së sigurisë teknike

PPG Coatings SPRL/BVBA
Tweemontstraat 104
B-2100 Deurne
Belgium
Telephone +32-33606311
Fax +32-33606435

Adresa e emailit të personit : PMC.Safety@PPG.com
përgjegjës për këtë SDS
(Dëftesë e Sigurisë
Teknike)

1.4 Numri i telefonit për urgjenca

Furnizuesi

+31 20 4075210

SEKSIONI 2: Identifikimi i rrezikshmërive

2.1 Klasifikimi i lëndës ose i përzierjes

Përkufizimi i produktit : Përzierje

Klasifikimi sipas Rregullores (EC) Nr. 1272/2008 [CLP/GHS]

Flam. Liq. 3, H226
Acute Tox. 4, H332
Skin Sens. 1, H317
STOT SE 3, H335
Aquatic Chronic 3, H412

Produkti klasifikohet si i rrezikshëm, sipas Rregullores (EC) 1272/2008 të amenduar.

Shih Seksionin 16 për tekstin e plotë të deklaratave H të parashtruara më lart.

Shihni seksionin 11 për të dhëna më të hollësishme lidhur me pasojat dhe simptomat shëndetësore.

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 2: Identifikimi i rrezikshmërive**2.2 Elemente të etiketës**

Piktograme të rrezikshmërisë



Fjalë sinjalizuese

: Paralajmërim

Njoftime të rrezikshmërisë

: Lëng dhe avull të ndezshëm.
E dëmshme po të frymëthithet.
Mund të shkaktojë një reaksion alergjik të lëkurës.
Mund të shkaktojë irritim të rrugëve të frymëmarrjes.
E dëmshme për gjallesat ujore me efekte afatgjata.

Njoftime paralajmëruese

Parandalim

: Përdorni doreza mbrojtëse. Përdorni rroba mbrojtëse. Përdorni mbrojtje për sytë ose fytyrën. Mbajeni larg nxehtësisë, sipërfaqeve të nxehta, shkëndijave, flakëve të gjalla dhe burimeve të tjera flakëmarrëse. Ndalohet duhani. Shmangni frymëthithjen e avujve.

Përgjigje

: PO TË FRYMËTHITHET: Nxirreni personin në ajër të freskët dhe ndihmoni që të marrë frymë pa pengesa. PO TË PREKË LËKURËN (ose flokët): Hiqni menjëherë të gjitha rrobat e ndotura. Shpëlajeni lëkurën me ujë.

Ruajtja

: Ruani në një vend të ajrosur mirë. Mbajeni të freskët.

Heqja/Asgjësimi

: Nuk zbatohet.

P280, P210, P261, P304 + P340, P303 + P361 + P353, P403, P235

Ingredientë të rrezikshëm

: Hexamethylene diisocyanate, oligomers (isocyanurate type)
hexamethylene-di-isocyanate

Elemente suplementare të etiketës

: Përmban izocianate. Mund të shkaktojë një reaksion alergjik.

Aneksi XVII – Kufizime në prodhimin, hedhjen në treg dhe përdorimin e disa lëndëve, përzierjeve dhe artikujve të rrezikshëm

: Nuk zbatohet.

Kërkesa të posaçme për paketimin

Enët duhen pajisur me kapëse rezistente ndaj fëmijëve

: Nuk zbatohet.

Paralajmërim i prekshëm i rrezikut

: Nuk zbatohet.

2.3 Rrezikshmëri të tjera

Rrezikshmëri të tjera që nuk figurojnë në klasifikim

: Kontakti i zgjatur ose i përsëritur rrezikon të çojë në tharje të lëkurës dhe të shkaktojë irritim.

SEKSIONI 3: Përbërja/të dhëna për ingredientët

3.2 Përzierje

: Përzierje

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 3: Përbërja/të dhëna për ingredientët

Emri i produktit/ingredientit	Identifikuesit	% me peshë	Klasifikimi Rregullorja (EC) Nr. 1272/2008 [CLP]	Lloji
Hexamethylene diisocyanate, oligomers (isocyanurate type)	REACH #: 01-2119485796-17 EC: 931-274-8 CAS: 28182-81-2	≥75 - ≤90	Acute Tox. 4, H332 Skin Sens. 1, H317 STOT SE 3, H335	[1] [2]
n-butyl acetate	REACH #: 01-2119485493-29 EC: 204-658-1 CAS: 123-86-4 Indeksi: 607-025-00-1	≥5.0 - <10	Flam. Liq. 3, H226 STOT SE 3, H336 EUH066	[1] [2]
Hydrocarbons, C9, aromatics	REACH #: 01-2119455851-35 EC: 918-668-5 CAS: 64742-95-6	≥5.0 - <10	Flam. Liq. 3, H226 STOT SE 3, H335 STOT SE 3, H336 Asp. Tox. 1, H304 Aquatic Chronic 2, H411 EUH066	[1]
hexamethylene-di-isocyanate	REACH #: 01-2119457571-37 EC: 212-485-8 CAS: 822-06-0 Indeksi: 615-011-00-1	≤0.30	Acute Tox. 4, H302 Acute Tox. 1, H330 Skin Irrit. 2, H315 Eye Irrit. 2, H319 Resp. Sens. 1, H334 Skin Sens. 1, H317 STOT SE 3, H335 Shih Seksionin 16 për tekstin e plotë të deklaratave H të parashtruara më lart.	[1] [2]

Nuk ka të pranishëm përbërës të tjerë që, me sa është në dijeni furnizuesi dhe në përqendrimit e zbatueshme, klasifikohen si të rrezikshëm për shëndetin ose mjedisin, janë PBT-të apo vPvB-të, ose të cilave u është bashkëlidhur një kufi ekspozimi në vendin e punës dhe prandaj duhen raportuar në këtë seksion.

Lloji

[1] Lëndë e klasifikuar me një rrezik për shëndetin apo për mjedisin

[2] Lëndë me një kufi ekspozimi në vendin e punës

[3] Lënda i kënaq kriteret për PBT sipas Rregullores (EC) Nr. 1907/2006, Aneksi XIII

[4] Lënda i kënaq kriteret për vPvB sipas Rregullores (EC) Nr. 1907/2006, Aneksi XIII

[5] Lëndë njëloj shqetësuese

[6] Deklaratë zbulimi shtesë për shkak të politikës së kompanisë

Kufijtë e ekspozimit në vendin e punës, nëse ekzistojnë, gjenden të renditur në seksionin 8.

Kodet SUB paraqesin sustancat pa numrat e regjistruar CAS.

SEKSIONI 4: Masa të ndihmës së parë**4.1 Përshkrim i masave të ndihmës së shpejtë****Kontakt me sytë**

: Kontrolloni për lente kontakti dhe hiqini nga sytë sipas rastit. Menjëherë shpëllajini sytë me ujë të rrjedhshëm për të paktën 10 minuta, duke i mbajtur qepallat të hapura. Kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore.

Frymëthithje

: Nxirrni në ajër të pastër. Mbajeni personin ngrohtë dhe në prehje. Nëse viktimi nuk po merr frymë, nëse frymëmarrja është e parregullt ose nëse ka ndodhur pushim i frymëmarrjes, i duhet dhënë frymëmarrje artificiale ose oksigjen nga personel i trajnuar.

Kontakti me lëkurën

: Hiqni rrobat dhe këpucët e ndotura. Lajeni mirë lëkurën me ujë dhe sapun, ose përdorni një pastrues lëkure të miratuar. Mos përdorni tretës ose hollues.

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 4: Masa të ndihmës së parë

- Gëlltitje** : Në rast gëlltitjeje, këshillohuni menjëherë me mjekun, duke ia treguar këtë enë ose etiketë. Mbajeni personin ngrohtë dhe në prehje. MOS provokoni të vjellë.
- Mbrojtje për personat që japin ndihmën e shpejtë** : Nuk duhet ndërmarrë asnjë veprim që shoqërohet me rrezikim të personit ose pa trajnim të përshtatshëm. Nëse dyshohet se ka ende tymra, forcat e shpëtimit duhet të përdorin maska të përshtatshme ose aparat frymëmarrjeje autonom. Mund të jetë e rrezikshme për ofruesin e ndihmës të japë frymëmarrje gojë-më-gojë. Lajini mirë me ujë rrobat e ndotura para se t'i hiqni, ose përdorni doreza.

4.2 Simptomat dhe efektet më të rëndësishme, akute dhe të vonuara**Efekte shëndetësore akute potenciale**

- Kontakt me sytë** : Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.
- Frymëthithje** : E dëmshme po të frymëthihet. Mund të shkaktojë irritim të rrugëve të frymëmarrjes.
- Kontakti me lëkurën** : Çyndyruet për lëkurën. Rrezikon të shkaktojë tharje dhe irritim të lëkurës. Mund të shkaktojë një reaksion alergjik të lëkurës.
- Gëlltitje** : Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.

Shenja/simptoma të mbi-eksponimit

- Kontakt me sytë** : Nuk ka të dhëna specifike.
- Frymëthithje** : Simptomat e padëshirueshme mund të përfshijnë sa vijon:
irritim i rrugëve të frymëmarrjes
kollë
- Kontakti me lëkurën** : Simptomat e padëshirueshme mund të përfshijnë sa vijon:
irritim
skuqje
tharje
plasaritje
- Gëlltitje** : Nuk ka të dhëna specifike.

4.3 Indikim për kujdesin dhe trajtimin mjekësor të menjëhershëm dhe trajtimin e posaçëm që mund të duhet

- Shënime për mjekun** : Në rast frymëthithjeje të produkteve të shpërbërjes gjatë një zjarri, simptomat mund të shfaqen me vonesë. Personi i ekspozuar mund të duhet mbajtur nën vëzhgim mjekësor për 48 orë.
- Trajtime specifike** : Nuk ka trajtim specifik.

SEKSIONI 5: Masa të luftës kundër zjarrit**5.1 Mjete zjarrfikëse**

- Mjete fikëse të përshtatshme** : Përdorni kimikat të thatë, CO₂, spërkatje me ujë (mjegull) ose shkumë.
- Mjete fikëse të papërshtatshme** : Mos përdorni rrymë uji.

5.2 Rrezikshmëri të posaçme nga lënda ose përzierja

- Rrezikshmëritë nga lënda ose përzierja** : Lëng dhe avull të ndezshëm. Derdhja në kanalet e ujërave të zeza mund të shkaktojë zjarr ose rrezik shpërthimi. Në rast zjarri ose nëse nxehet, do të shkaktohet rritje trysnie dhe ena mund të plasë, madje duke rrezikuar që pastaj të shpërthejë. Ky material është i dëmshëm me efekte afatgjata për gjallesat ujore. Uji i përdorur për shuarje zjarri që është ndotur me këtë material nuk duhet lejuar të shkarkohet në vija ujore, kanale të ujërave të zeza ose kanale shkarkimi.

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 5: Masa të luftës kundër zjarrit

Produkte të rrezikshme të djegies : Produktet e shpërbërjes mund të përfshijnë materialet e mëposhtme:
 okside karboni
 okside azoti
 Cianat dhe izocianat.
 cianur hidrogjeni

5.3 Këshilla për zjarrfikësit

Paralajmërime të posaçme për zjarrfikësit : Izoloheni menjëherë skenën, duke i larguar të gjithë të pranishmit nga vendi i incidentit, në rast se ka rënë zjarr. Nuk duhet ndërmarrë asnjë veprim që shoqërohet me rrezikim të personit ose pa trajnim të përshtatshëm. Hiqini enët nga zona ku ka rënë zjarr, nëse kjo mund të bëhet pa rrezik. Përdorni rrymë uji për t'i mbajtur të freskët enët e ekspozuara ndaj zjarrit.

Pajisje mbrojtëse e posaçme për zjarrfikësit : Zjarrfikësit duhet të veshin pajisje mbrojtëse të përshtatshme dhe aparat respirator autonom (SCBA, në anglishte), me maskë të plotë dhe të regjistruar për funksionim në trysni pozitive. Veshjet për zjarrfikësit (duke përfshirë helmetat, çizmet mbrojtëse dhe dorezat) në pajtim me Standardin europian EN 469 do të ofrojnë një nivel bazë mbrojtjeje për incidentet kimike.

SEKSIONI 6: Masa në rast çlirimi aksidental**6.1 Paralajmërime personale, pajisje mbrojtëse dhe procedura të urgjencës**

Për personel jo të ndërhyrjes urgjente : Nuk duhet ndërmarrë asnjë veprim që shoqërohet me rrezikim të personit ose pa trajnim të përshtatshëm. Evakuoni (boshatisni) zonat përreth. Mos lejoni të hyjë personel i panevojshëm dhe i pambrojtur. Mos e prekni materialin e derdhur, as mos ecni nëpër të. Mbyllini të gjitha burimet e ndezjes. Në zonën me rrezikshmëri nuk lejohen pishtarët, duhani dhe flakët. Mos frymëthithni avullin ose mjegullimin. Siguroni ajrim të mjaftueshëm. Përdorni një aparat respirator të përshtatshëm, kur ajrosja është e pamjaftueshme. Përdorni pajisje të përshtatshme të mbrojtjes personale.

Për shërbimet e ndërhyrjes urgjente : Në qoftë se kërkohet veshje e specializuar për të trajtuar derdhjen, merrni parasysh çdo informacion në Seksionin 8 për materialet e përshtatshme dhe të papërshtatshme. Shihni edhe informacionin në "Për personel jo të ndërhyrjes urgjente".

6.2 Masa paraprake për mjedisin

: Shmangni përhapjen e materialit të derdhur, rrjedhjen dhe kontaktin me dheun, vijat ujore, kanalet shkarkuese dhe kanalet e ujërave të zeza. Njoftoni autoritetet përkatëse në rast se produkti ka shkaktuar ndotje të mjedisit (ujërat e zeza, vijat ujore, tokësore ose ajrore). Materiali ndotës i ujit. Mund të jetë e dëmshme për mjedisin po të çlirohet në sasi të mëdha.

6.3 Metoda dhe materiale për kontroll dhe pastrim

Derdhje e vogël : Ndaleni rrjedhën pa u rrezikuar. Hiqini enët nga zona ku ka ndodhur derdhja. Përdorni vegla që nuk lëshojnë shkëndija dhe pajisje të përshtatshme për mjedisë me rrezik shpërthimi. Hollojeni me ujë dhe hiqeni me shtup po të jetë e tretshme me ujë. Përndryshe, ose nëse nuk tretet me ujë, thitheni me një material të thatë inert dhe vendoseni në një enë të përshtatshme për heqje/eliminim të mbetjeve. Eliminoheni nëpërmjet një kontraktori të licencuar për eliminimin e mbetjeve.

Derdhje e madhe : Ndaleni rrjedhën pa u rrezikuar. Hiqini enët nga zona ku ka ndodhur derdhja. Përdorni vegla që nuk lëshojnë shkëndija dhe pajisje të përshtatshme për mjedisë me rrezik shpërthimi. Afrojuni zonës ku është çliruar materiali me erë në shpinë, jo në fytyrë. Mos lejoni hyrje në kanale të ujërave të zeza, vija ujore, bodrume të nëndheshme ose zona të mbyllura. Kalojini derdhjet në një impiant të trajtimit të mbetjeve të lëngshme ose procedoni si vijon. Izolohini dhe grumbullojini derdhjet e vogla me material përthithës të padjeggshëm, të tillë si rërë, dhé, vermikulit ose miell

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 6: Masa në rast çlirimi aksidental

fosil, pastaj mblidheni materialin në një enë për heqje/eliminim në pajtim me rregulloret vendore. Eliminojeni nëpërmjet një kontraktori të licencuar për eliminim e mbetjeve. Materiali përthithës i ndotur rrezikon të paraqitë të njëjtën rrezikshmëri si edhe produkti i derdhur.

Dispozita të posaçme : Izolojini dhe grumbullojini derdhjet e vogla me material përthithës të padjegshëm, të tillë si rërë, dhé, vermikulit ose miell fosil, pastaj mblidheni materialin në një enë për heqje/eliminim në pajtim me rregulloret vendore (shihni Seksionin 13). Vendoseni në një enë të përshtatshme. Zona e ndotur duhet pastruar menjëherë me një çndotës të përshtatshëm. Një çndotës i mundshëm (i ndezshëm) do të ishte (me volum): ujë (45 pjesë), etanol ose alkool izopropilik (50 pjesë) dhe tretësirë e përqendruar (d: 0,880) amoniaku (5 pjesë). Alternativë e pandezshme do të ishte karbonat natriumi (5 pjesë) dhe ujë (95 pjesë). Hidheni të njëjtin çndotës mbi mbeturinat dhe lëreni ashtu për disa ditë në një enë të pambyllur, derisa të mos ketë më reaksion. Kur të arrihet kjo fazë, mbylleni enën dhe hiqeni/eliminojeni në pajtim me rregulloret vendore (shihni seksionin 13). Mos lejoni të hyjë në kanale shkarkimi ose vija uji. Në rast se produkti shkakton ndotje të liqeneve, lumenjve ose kanaleve të ujërave të zeza, njoftoni autoritetet përkatëse në pajtim me rregulloret vendore.

6.4 Referencë në seksione të tjera : Shihni Seksionin 1 për informacion të kontaktit në rast urgjence.
Shihni Seksionin 8 për informacion në lidhje me pajisjet e përshtatshme të mbrojtjes personale.
Shihni Seksionin 13 për informacion të mëtejshëm rreth trajtimit të mbetjeve.

SEKSIONI 7: Trajtimi dhe ruajtja

Informacioni në këtë seksion përmban këshilla dhe udhëzime të përgjithshme. Për çdo informacion specifik ndaj një përdorimi që ofrohet në Skenarin/et e Ekspozimit, duhet këshilluar Lista e Përdorimeve të Identifikuara në Seksionin 1.

7.1 Masa paraprake për trajtim të sigurtë

Masa mbrojtëse : Vishni pajisje të përshtatshme për mbrojtje personale (shihni seksionin 8). Në zonën ku trajtohet, ruhet dhe përpunohet ky material, nuk duhet lejuar ngrënia, pirja dhe duhani. Punëtorët duhet të lajnë duart dhe fytyrën para se të hanë, të pinë ose të tymosin duhan. Hiqni veshjet dhe pajisjet mbrojtëse të ndotura, para se të futeni në zonat e ngrënies. Mos e gëlltitni. Shmangni kontaktin me sytë, lëkurën dhe veshjet. Mos frymëthithni avullin ose mjegullimin. Përdoreni vetëm nëse ka ajrim të mjaftueshëm. Përdorni një aparat respirator të përshtatshëm, kur ajrosja është e pamjaftueshme. Mos u futni në zona të magazinimit dhe në mjedise të mbyllura, nëse nuk janë të ajruara mirë. Mbajeni në enën origjinale ose në enë rezervë të miratuar, prej materiali të pajtueshëm, të mbajtur mbyllur mirë kur nuk është në përdorim. Ruajeni dhe përdoreni larg nxehtësisë, shkëndijave, flakës së hapur ose ndonjë burimi tjetër ndezës. Përdorni pajisje elektrike (për ajrim, ndriçim dhe trajtim të materialit) të tilla që nuk mund të krijojnë rrezik shpërthimi (p.sh. që nuk kanë shkëndija të ekspozuara). Përdorni vegla që nuk lëshojnë shkëndija. Merrni masa parambrojtëse kundër shkarkimeve elektrostатike. Për të shmangur zjarr ose shpërthim, shpërhapeni elektricitetin statik gjatë transferimit duke i tokëzuar dhe duke i lidhur së bashku kontejnerët dhe pajisjet para se të filloni të transferoni materialin. Enët e zbrazët mund të kenë ruajtur mbeturina të produktit dhe të përbëjnë rrezik. Mos e ripërdorni enën.

Këshilla për higjienën e përgjithshme në vendin e punës : Në zonën ku trajtohet, ruhet dhe përpunohet ky material, nuk duhet lejuar ngrënia, pirja dhe duhani. Punëtorët duhet të lajnë duart dhe fytyrën para se të hanë, të pinë ose të tymosin duhan. Hiqni veshjet dhe pajisjet mbrojtëse të ndotura, para se të futeni në zonat e ngrënies. Shihni edhe Seksionin 8 për informacion të mëtejshëm rreth masave higjienike.

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 7: Trajtimi dhe ruajtja**7.2 Kushtet për ruajtje të sigurt, duke përfshirë edhe papajtueshmëritë e mundshme**

: Ruajeni midis temperaturave të mëposhtme: 0 në 35°C (32 në 95°F). Ruajeni sipas rregulloreve vendore. Ruajeni në një zonë të veçuar dhe të miratuar. Ruajeni në enën origjinale të mbrojtur nga drita e drejtpërdrejtë e diellit, në një zonë të freskët dhe të ajruar mirë, larg nga materiale të papajtueshme (shihni Seksionin 10), si dhe nga ushqimet dhe pijet. Ruajeni të mbyllur me çelës. Eliminoni të gjitha burimet ndezëse. Mbajeni të veçuar prej materialeve oksiduese. Mbajeni enën të mbyllur hermetikisht dhe të vulosur derisa të jeni gati për ta përdorur. Enët që janë hapur duhet të mbyllen përsëri hermetikisht me kujdes dhe të mbahen në pozicion vertikal për të parandaluar rrjedhjet. Mos e ruani në enë të paetiketuar. Merrni masa të përshtatshme penguese, për të shmangur ndotjen e mjedisit. Përpara trajtimit ose përdorimit, shihni pjesën 10 për materialet e papajtueshme.

Duhet marrë masa paraprake për ta minimizuar ekspozimin ndaj lagështisë atmosferike ose ujit. Do të krijohet CO₂, çka mund të shpjerë në presurizim në raste kontejnerësh të mbyllur.

7.3 Përdorim(e) përfundimtar(e) i(të) posaçëm(me)

Shihni Seksionin 1.2 për përdorime të identifikuar

SEKSIONI 8: Kontrollat e ekspozimit/mbrojtja personale

Informacioni në këtë seksion përmban këshilla dhe udhëzime të përgjithshme. Për çdo informacion specifik ndaj një përdorimi që ofrohet në Skenarin/et e Ekspozimit, duhet këshilluar Lista e Përdorimeve të Identifikuar në Seksionin 1.

8.1 Parametra të kontrollit**Kufij të ekspozimit në vendin e punës**

Emri i produktit/ingredientit	Vlera të kufirit të ekspozimit
Hexamethylene diisocyanate, oligomers (isocyanurate type)	EH40/2005 WELs (Mbretëri e Bashkuar (UK), 12/2011). Përndjeshmues nëpërmjet frymëthithjes. STEL: 0.07 mg/m ³ , (as NCO) 15 minuta. TWA: 0.02 mg/m ³ , (as NCO) 8 orë.
n-butyl acetate	EH40/2005 WELs (Mbretëri e Bashkuar (UK), 12/2011). STEL: 966 mg/m ³ 15 minuta. STEL: 200 ppm 15 minuta. TWA: 724 mg/m ³ 8 orë. TWA: 150 ppm 8 orë.
hexamethylene-di-isocyanate	EH40/2005 WELs (Mbretëri e Bashkuar (UK), 12/2011). Përndjeshmues nëpërmjet frymëthithjes. STEL: 0.07 mg/m ³ , (as NCO) 15 minuta. TWA: 0.02 mg/m ³ , (as NCO) 8 orë.

Procedura monitorizimi të këshilluara

: Nëse ky produkt përmban ingredientë me kufij ekspozimi, mund të jetë i nevojshëm monitorizim personal, i vendit të punës, atmosferik ose biologjik për të përcaktuar efektshmërinë e ajrimit ose masave të tjera të kontrollit dhe/ose nevojën për të përdorur pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes. U duhet referuar standardeve të monitorimit, të tilla si: Standardi Europian EN 689 (Ajri në vendin e punës – Udhëzime për vlerësimin e ekspozimit me frymëthithje ndaj agjentëve kimikë për krahasim me vlerat limit dhe strategjinë e matjeve) Standardi Europian EN 14042 (Ajri në vendin e punës – Udhëzime për zbatimin dhe përdorimin e procedurave për vlerësimin e ekspozimit ndaj agjentëve kimikë dhe biologjikë) Standardi Europian EN 482 (Ajri në vendin e punës – Kërkesa të përgjithshme për ekzekutimin e procedurave për matjen e agjentëve kimikë) Do të jetë i nevojshëm edhe referimi ndaj dokumenteve udhëzuese në rang shtetëror për metodat e përcaktimit të lëndëve me rrezikshmëri.

DNEL

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 8: Kontrollat e ekspozimit/mbrojtja personale

Emri i produktit/ingredientit	Lloji	Ekspozimi	Vlera	Popullata	Efektet	
Hexamethylene diisocyanate, oligomers (isocyanurate type)	DNEL	Afatgjatë	0.5 mg/m ³	Punëtorët	Lokal	
	DNEL	Frymëthithje Afatshkurtër	1 mg/m ³	Punëtorët	Lokal	
n-butyl acetate	DNEL	Frymëthithje Afatgjatë	480 mg/m ³	Punëtorët	Sistemik	
	DNEL	Frymëthithje Afatshkurtër	960 mg/m ³	Punëtorët	Sistemik	
	DNEL	Frymëthithje Afatgjatë	480 mg/m ³	Punëtorët	Lokal	
	DNEL	Frymëthithje Afatshkurtër	960 mg/m ³	Punëtorët	Lokal	
	DNEL	Frymëthithje Afatgjatë	102.34 mg/m ³	Konsumatorët	Sistemik	
	DNEL	Frymëthithje Afatshkurtër	859.7 mg/m ³	Konsumatorët	Sistemik	
Hydrocarbons, C9, aromatics	DNEL	Frymëthithje Afatgjatë	102.34 mg/m ³	Konsumatorët	Lokal	
	DNEL	Frymëthithje Afatshkurtër	859.7 mg/m ³	Konsumatorët	Lokal	
	DNEL	Frymëthithje Afatgjatë	150 mg/m ³	Punëtorët	Sistemik	
	DNEL	Frymëthithje Afatgjatë Dermal	25 mg/kg bw/ditë	Punëtorët	Sistemik	
	DNEL	Frymëthithje Afatgjatë	32 mg/m ³	Konsumatorët	Sistemik	
	DNEL	Frymëthithje Afatgjatë Dermal	11 mg/kg bw/ditë	Konsumatorët	Sistemik	
	DNEL	Frymëthithje Afatgjatë Gojor	11 mg/kg bw/ditë	Konsumatorët	Sistemik	
	hexamethylene-di-isocyanate	DNEL	Frymëthithje Afatgjatë	0.035 mg/m ³	Punëtorët	Sistemik
		DNEL	Frymëthithje Afatshkurtër	0.07 mg/m ³	Punëtorët	Sistemik
		DNEL	Frymëthithje Afatgjatë	0.035 mg/m ³	Punëtorët	Lokal
DNEL		Frymëthithje Afatshkurtër	0.07 mg/m ³	Punëtorët	Lokal	

PNEC

Emri i produktit/ingredientit	Lloji	Hollësi për Mjedisin Përkatës	Vlera	Hollësi për Metodën
Hexamethylene diisocyanate, oligomers (isocyanurate type)	-	Ujë i ëmbël	0.127 mg/l	Faktorët e Vlerësimit
	-	Ujë deti	0.0127 mg/l	Faktorët e Vlerësimit
	-	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Zeza	88 mg/l	Faktorët e Vlerësimit
	-	Sediment uji të ëmbël	266701 mg/kg dwt	Përndarje e Drejtpeshimit
	-	Sediment uji të kripur	26670 mg/kg dwt	Përndarje e Drejtpeshimit
	-	Dhé	53182 mg/kg	Përndarje e Drejtpeshimit
n-butyl acetate	-	Ujë i ëmbël	0.18 mg/l	-
	-	Ujë deti	0.018 mg/l	-

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 8: Kontrollat e ekspozimit/mbrojtja personale

hexamethylene-di-isocyanate	-	Sediment uji të ëmbël	0.981 mg/kg	-
	-	Sediment uji të kripur	0.0981 mg/kg	-
	-	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Zeza	35.6 mg/l	-
	-	Dhé	0.0903 mg/kg	-
	-	Ujë i ëmbël	0.0774 mg/l	Faktorët e Vlerësimit
	-	Ujë deti	0.00774 mg/l	Faktorët e Vlerësimit
	-	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Zeza	8.42 mg/l	Faktorët e Vlerësimit
	-	Sediment uji të ëmbël	0.01334 mg/kg dwt	Përndarje e Drejtpeshimit
	-	Sediment uji të kripur	0.001334 mg/kg dwt	Përndarje e Drejtpeshimit
	-	Dhé	0.0026 mg/kg dwt	Përndarje e Drejtpeshimit

8.2 Kontrollat të ekspozimit**Komanda inxhinierike të përshtatshme**

: Përdoren vetëm nëse ka ajrim të mjaftueshëm. Përdorni rrethore përpunimi, ajrim shkarkues vendor ose mënyra të tjera kontrolli inxhinierike për ta mbajtur ekspozimin e punëtorëve ndaj ndotësve ajrorë nën kufijtë e këshilluar ose përcaktuar me rregullore. Mënyrat inxhinierike të kontrollit gjithashtu duhet t'i mbajnë përqendrimet e gazit, avullit ose pluhurit në vlera nën kufijtë më të ulët të shpërthimit. Përdoni pajisje ajrimi që nuk përmbajnë rrezik shpërthimi.

Masa të mbrojtjes individuale**Masa higjienike**

: Pasi të keni punuar me produkte kimike, lajini duart, parakrahët dhe fytyrën mirë e me kujdes, para se të hani, të pini duhan, të përdorni shërbimet higjienike dhe në përfundim të orarit të punës. Për të hequr veshjet që mund të jenë ndotur me material, duhen përdorur teknika të përshtatshme. Rrobat e punës të ndotura nuk duhen nxjerrë jashtë vendit të punës. Lajini rrobat e ndotura para se t'i përdorni përsëri. Sigurohuni që pikat e posaçme për larje sysh dhe dushet e sigurimit janë në afërsi të vendit të punës.

Mbrojtje për sytë/fytyrën

: Syze mbrojtëse sigurie me mburoja anësore. Përdorni mbrojtjen e syve sipas EN 166.

Mbrojtje për lëkurën**Mbrojtje për duart**

: Kur punoni me produkte kimike duhet të mbani gjatë gjithë kohës doreza kemio-rezistente dhe të papërshkueshme, nëse kjo rezulton e nevojshme nga vlerësimi që i bëhet rrezikut. Duke mbajtur parasysh parametrat e specifikuar nga fabrikanti i dorezës, kontrolloni nëse dorezat po i ruajnë ende vetitë e tyre mbrojtëse gjatë përdorimit. Duhet pasur parasysh se kohëzgjatja maksimale e përdorimit të dorezave të çfarëdolloj materiali mund të ndryshojë nga një markë dorezash në tjetrën. Në rast përzjeresh të lëndëve të ndryshme, kohëzgjatja e mbrojtjes që ofrojnë dorezat nuk mund të përafrohet me saktësi. Kur zgjatur ose kontaktit të përsëritur herë pas here mund të ndodhë, një dorezë me një klasë të mbrojtjes prej 6 (koha përparim më të madh se 480 minuta sipas EN 374) është i rekomanduar. Kur vetëm kontakti të shkurtër pritet, një dorezë me një klasë të mbrojtjes prej 2 ose më të lartë (koha përparim më të madh se 30 minuta sipas EN 374) është i rekomanduar. Përdoruesi duhet të sigurohet se zgjedhja përfundimtare e llojit të dorezës për t'u përdorur në trajtimin e këtij produkti është më e përshtatshme dhe merr parasysh kushtet specifike të përdorimit, sikurse janë përcaktuar në vlerësimin e vetë përdoruesit.

Doreza

: gomë butili

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 8: Kontrollat e ekspozimit/mbrojtja personale

- Mbrojtje për trupin** : Pajisjet e mbrojtjes personale për trupin duhen përzgjedhur në bazë të detyrës që duhet kryer dhe rreziqeve përkatëse, si dhe miratuar nga një specialist para se të trajtohet ky produkt. Atje ku ekziston rreziku i ndezjes për shkak të elektricitetit statik, përdorni veshje mbrojtëse anti-statike. Për mbrojtje optimale nga shkarkesat elektrostатike, veshja duhet të përfshijë kominoshe, çizme dhe doreza anti-statike. Referojuni Standardit Europian EN 1149 për të dhëna të mëtejshme për kërkesat në lidhje me materialin dhe dizajnin si dhe për metodat e testimit.
- Mbrojtje tjetër për lëkurën** : Këpucët e përshtatshme dhe masat e mëtejshme mbrojtëse për lëkurën duhet të përzgjidhen sipas detyrës që po kryhet dhe rreziqeve që lidhen me të, si dhe duhen miratuar nga një specialist para se të trajtohet produkti.
- Mbrojtje për frymëmarrjen** : Në rast spërkatjeje: aparat respirator i ushqyer me ajër. Gjatë procesesh të tjera të ndryshme nga spërkatja, në zona të ajruara mirë, aparatet respiratore të ushqyera me ajër mund të zëvendësohen nga një kombinim i një filtri qymyri dhe një maske me filtër partikulatësh. Përzgjedhja e aparatit respirator duhet të bazohet në nivelet e njohura ose të pritura të ekspozimit, rreziqet që paraqet produkti dhe kufijtë e funksionimit të sigurtë të aparatit të përzgjedhur. Nëse punëtorët u ekspozohen përqendrimeve mbi kufirin e ekspozimit, duhet të përdorin aparate respiratore të përshtatshme dhe të miratuara. Përdorni një aparat respirator ajërfiltrues ose të ushqyer me ajër të masës suaj e që i përgjigjet një standardi të miratuar, nëse kjo rezulton e nevojshme nga vlerësimi që i bëhet rrezikut. Vishni një respirator në përputhje me EN140. Lloji i filtrit: filtër avujsh organikë (Tipi A) dhe grimcash P3
- Kufizime përdorimi** : Personat që dihet se vuajnë nga astma, alergji të ndryshme, ose sëmundje kronike a të përsëritura të rrugëve të frymëmarrjes nuk duhet të marrin pjesë në asnjë proces pune ku përdoret ky produkt.
- Kontrolle të ekspozimit mjedisor** : Prurjet e sistemit të ajrimit ose e pajisjeve të procesit të punës duhen kontrolluar për t'u siguruar se u përmbahen kërkesave të ligjshmërisë për mbrojtjen e mjedisit. Në disa raste do të jetë e nevojshme të përdoren skruher tymrash, filtra ose modifikime inxhinierike të pajisjeve përpunuese, për t'i reduktuar emisionet deri në nivele të pranueshme.

SEKSIONI 9: Vetitë fizike dhe kimike**9.1 Informacion për vetitë fizike dhe kimike themelore****Pamja**

- Gjendja fizike** : Lëng.
- Ngjyra** : Nuk zotërohet.
- Kundërmimi** : Nuk zotërohet.
- Pragu i kundërmimit** : Nuk zotërohet.
- pH** : i patretshëm në ujë.
- Pika e shkrirjes/pika e ngrirjes** : Mund të nisë të ngurtësohet në temperaturën e mëposhtme: -51.3 në -28.4°C (-60.3 në -19.1°F) Kjo bazohet në të dhëna për përbërësin (ingredientin) e mëposhtëm: Hexamethylene diisocyanate, oligomers (isocyanurate type). Mesatare e peshuar: -43.59°C (-46.5°F)
- Pika fillestare e vlimit dhe intervali i vlimit** : >37.78°C
- Pika e flakërimit** : Closed cup (Kupë e mbyllur): 31°C
- Shpejtësia e avullimit** : 1 (n-butyl acetate) në krahasim me acetat butili
- Materiali e ndihmon djegien.** : Po.
- Ndezshmëria (lëndë e ngurtë ose gaz)** : lëng

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 9: Vetitë fizike dhe kimike

- Ndezshmëria e sipërme/e poshtme ose kufijtë e shpërthimit** : Intervali më i madh që njihet: I poshtëm: 1.4% I sipërm: 7.6% (n-butyl acetate)
- Presioni i avullit** : Vlera më e lartë që njihet: 1.5 kPa (11.3 mm Hg) (në 20°C) (n-butyl acetate).
Mesatare e peshuar: 0.09 kPa (0.68 mm Hg) (në 20°C)
- Dendësia e avullit** : Vlera më e lartë që njihet: 4.1 (Ajri = 1) (1,2,4-trimethylbenzene). Mesatare e peshuar: 4.02 (Ajri = 1)
- Denduria relative** : 1.13
- Tretshmëria/të** : I patretshëm në materialet e mëposhtme: ujë i ftohtë.
- Koeficienti i përndarjes oktanol/ujë** : Nuk zbatohet.
- Temperatura e vetëndezjes** : Vlera më e ulët që njihet: 280 në 470°C (536 në 878°F) (Solvent naphtha (petroleum), light aromatic).
- Temperatura e shpërbërjes** : I qëndrueshëm nëse ndiqen rekomandimet për ruajtje dhe trajtim (shihni Seksionin 7).
- Viskoziteti (ngjitshmëri)** : Kinematike (temperaturë dhome): >4 cm²/s
Kinematike (40°C): >0.21 cm²/s
- Vetitë shpërthyes** : Vetë produkti nuk është shpërthyes, por është i mundshëm formimi i një përzierjeje shpërthyes të avullit ose pluhurit me ajrin.
- Veti oksiduese** : Produkt nuk paraqet një rrezik oxidizing.

9.2 Të dhëna të tjera

S'ka të dhëna të mëtejshme.

SEKSIONI 10: Qëndrueshmëria dhe reaktiviteti

- 10.1 Reaktiviteti** : Nuk ekzistojnë të dhëna testesh specifike ndaj reaktivitetit për këtë produkt ose përbërësit e tij.
- 10.2 Qëndrueshmëria kimike** : Produkti është i qëndrueshëm.
- 10.3 Mundësi reaksionesh të rrezikshme** : Në kushte normale të ruajtjes dhe përdorimit nuk do të ndodhin reaksione të rrezikshme.
- 10.4 Rrethana për t'u shmangur** : Në rast zjarri, mund të prodhohen produkte të rrezikshme të shpërbërjes.

Referojuni masave mbrojtëse të përmendura në seksionet 7 dhe 8.
- 10.5 Materiale të papajtueshme** : Mbajeni larg: agjentë oksidues, alkale të forta, acide të forta, amina, alkoole, ujë. Me aminat dhe alkoolet do të ndodhin reaksione ekzotermike të pakontrolluara.
- 10.6 Produkte të rrezikshme të shpërbërjes** : Në varësi të kushteve, produkte dekompozimi mund të përfshijnë materialet e mëposhtme: Cianat dhe izocianat. okside karboni okside azoti cianur hidrogjeni

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 11: Të dhëna toksikologjike**11.1 Informacion për efektet toksikologjike****Toksiciteti akut**

Emri i produktit/ ingredientit	Rezultati	Specie	Doza	Ekspozimi
Hexamethylene diisocyanate, oligomers (isocyanurate type)	LD50 Dermal	Lepur	>2000 mg/kg	-
	LD50 Gojor	Mi fushe - Femër	>2500 mg/kg	-
n-butyl acetate	LC50 Frymëthithje Avulli	Mi fushe	>21.1 mg/l	4 orë
	LC50 Frymëthithje Avulli	Mi fushe	2000 ppm	4 orë
Hydrocarbons, C9, aromatics	LD50 Dermal	Lepur	>17600 mg/kg	-
	LD50 Gojor	Mi fushe	10.768 g/kg	-
	LD50 Dermal	Lepur	>3160 mg/kg	-
	LD50 Gojor	Mi fushe - Femër	3492 mg/kg	-
hexamethylene-di-isocyanate	LC50 Frymëthithje Pluhura dhe mjegullime	Mi fushe	124 mg/m ³	4 orë
	LC50 Frymëthithje Avulli	Mi fushe	151 mg/m ³	4 orë
	LC50 Frymëthithje Avulli	Mi fushe	22 ppm	4 orë
	LD50 Dermal	Lepur	0.57 g/kg	-
	LD50 Gojor	Mi fushe	0.71 g/kg	-

Përfundim/Përmbledhje : Nuk ka të dhëna të përdorshme për përzierjen vetë.**Vlerësime paraprake të toksicitetit akut**

Rruga	Vlera ATE (Ekuivalent i Toksicitetit Akut)
Frymëthithje (avuj)	101.3 mg/l
Frymëthithje (pluhura dhe mjegullime)	1.669 mg/l

Irritim/Gërryerje**Përfundim/Përmbledhje****Lëkura** : Nuk ka të dhëna të përdorshme për përzierjen vetë.**Sy** : Nuk ka të dhëna të përdorshme për përzierjen vetë.**I sistemit të frymëmarrjes** : Nuk ka të dhëna të përdorshme për përzierjen vetë.**Mbindjeshmim****Përfundim/Përmbledhje****Lëkura** : Nuk ka të dhëna të përdorshme për përzierjen vetë.**I sistemit të frymëmarrjes** : Nuk ka të dhëna të përdorshme për përzierjen vetë.**Mutageniciteti****Përfundim/Përmbledhje** : Nuk ka të dhëna të përdorshme për përzierjen vetë.**Karcinogjeniciteti****Përfundim/Përmbledhje** : Nuk ka të dhëna të përdorshme për përzierjen vetë.**Toksicitet riprodhues****Përfundim/Përmbledhje** : Nuk ka të dhëna të përdorshme për përzierjen vetë.**Teratogjeniciteti****Përfundim/Përmbledhje** : Nuk ka të dhëna të përdorshme për përzierjen vetë.**Toksiciteti specifik për organin e shënjestruar (një ekspozim i vetëm)**

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 11: Të dhëna toksikologjike

Emri i produktit/ingredientit	Kategoria	Rruga e ekspozimit	Organet e shënjestruara
Hexamethylene diisocyanate, oligomers (isocyanurate type)	Kategoria 3	Nuk zbatohet.	Irritim i rrugëve të frymëmarrjes
n-butyl acetate	Kategoria 3	Nuk zbatohet.	Efekte narkotike
Hydrocarbons, C9, aromatics	Kategoria 3	Nuk zbatohet.	Irritim i rrugëve të frymëmarrjes dhe Efekte narkotike
hexamethylene-di-isocyanate	Kategoria 3	Nuk zbatohet.	Irritim i rrugëve të frymëmarrjes

Toksiciteti specifik për organin e shënjestruar (ekspozim i përsëritur)

Nuk zotërohet.

Rrezikshmëri aspirimi

Emri i produktit/ingredientit	Rezultati
Hydrocarbons, C9, aromatics	RREZIKSHMËRIA NË RAST ASPIRIMI/ THITHJEJE - Kategoria 1

Të dhëna për rrugët e mundshme të ekspozimit : Nuk zotërohet.**Efekte shëndetësore akute potenciale**

- Frymëthithje** : E dëmshme po të frymëthithet. Mund të shkaktojë irritim të rrugëve të frymëmarrjes.
- Gëlltitje** : Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.
- Kontakti me lëkurën** : Çyndyruet për lëkurën. Rrezikon të shkaktojë tharje dhe irritim të lëkurës. Mund të shkaktojë një reaksion alergjik të lëkurës.
- Kontakt me sytë** : Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.

Simptoma që kanë lidhje me karakteristikat fizike, kimike dhe toksikologjike

- Frymëthithje** : Simptomat e padëshirueshme mund të përfshijnë sa vijon:
irritim i rrugëve të frymëmarrjes
kollë
- Gëlltitje** : Nuk ka të dhëna specifike.
- Kontakti me lëkurën** : Simptomat e padëshirueshme mund të përfshijnë sa vijon:
irritim
skuqje
tharje
plasaritje
- Kontakt me sytë** : Nuk ka të dhëna specifike.

Efekte të menjëhershme dhe të vonuara, si dhe efekte kronike nga ekspozimi afatshkurtër dhe afatgjatë**Ekspozimi afatshkurtër**

- Efekte të menjëhershme të mundshme** : Nuk zotërohet.
- Efekte të vonuara të mundshme** : Nuk zotërohet.

Ekspozimi afatgjatë

- Efekte të menjëhershme të mundshme** : Nuk zotërohet.
- Efekte të vonuara të mundshme** : Nuk zotërohet.

Efekte shëndetësore kronike potenciale

Nuk zotërohet.

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 11: Të dhëna toksikologjike

Përfundim/Përmbledhje	: Nuk zotërohet.
Të përgjithshme	: Kontakti i zgjatur ose i përsëritur mund të shkaktojë çyndyrim të lëkurës dhe të çojë në iritim, plasaritje dhe/ose dermatit. Pas përndjeshmimit, mjafton edhe një ekspozim ndaj vlerave shumë të ulëta për të shkaktuar reaksion të rëndë alergjik.
Karcinogjeniciteti	: Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.
Mutagjeniciteti	: Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.
Teratogjeniciteti	: Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.
Efekte zhvillimore	: Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.
Efekte ndaj pjellshmërisë	: Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.
Të dhëna të tjera	: Nuk zotërohet.

Nuk ka të dhëna të përdorshme për përzierjen vetë. Përzierja është vlerësuar sipas metodës konvencionale të përshkruar në Rregullore (EC) Nr. 1272/2008 dhe është klasifikuar sipas rrezikshmërisë toksikologjike përkatëse. Shihni Seksionet 2 dhe 3 për hollësi të mëtejshme.

Ekspozimi ndaj përqendrimeve të avujve të tretësve mbi kufijtë e përcaktuar të ekspozimit në vendin e punës mund të japë efekte shëndetësore të padëshiruara, të tilla si iritim të membranave mukoze dhe të rrugëve të frymëmarrjes dhe efekte të padëshiruara në veshka, mëlçi dhe sistemin nervor qendror. Ndër shenjat dhe simptomat duhen përmendur dhimbje koke, marrje mendsh, kapitje, dobësi muskulare, përgjumje dhe, në raste të skajshme, humbje e ndjenjave. Tretësit mund t'i shkaktojnë disa prej efekteve të mësipërme duke u përthithur nëpërmjet lëkurës.

Po të spërkatet në sy, lëngu mund të shkaktojë iritim dhe dëmtim të kthyesëm.

Kontakti i përsëritur ose i zgjatur me përzierjen mund të shkaktojë largimin e yndyrës natyrore nga lëkura, duke çuar në dermatit kontakti jo-alergjik dhe përthithje nëpërmjet lëkurës. Kjo merr parasysh, atje ku njihen, efektet e vonuara dhe të menjëhershme si dhe efektet kronike të përbërësve nga ekspozimi afatshkurtër dhe afatgjatë nëpërmjet rrugëve gojore, frymëthithëse dhe dermale të ekspozimit dhe kontaktit me sytë.

Në bazë të vetive të komponimeve të izocianatit dhe duke pasur parasysh të dhënat toksikologjike për përzierje të ngjashme, kjo përzierje mund të shkaktojë iritim akut dhe/ose përndjeshmim të sistemit të rrugëve të frymëmarrjes, duke çuar në gjendje astmatike, gulçim dhe shtrëngim në gjoks. Personat e përndjeshmuar mund të shfaqin më pas simptoma astmatike edhe kur u ekspozohen përqendrimeve atmosferike mjaft më të ulëta se OEL (Kufiri i Ekspozimit në Vendin e Punës). Ekspozimi i përsëritur mund të çojë në dëmtim të përhershëm të rrugëve të frymëmarrjes. Kontakti i zgjatur ose i përsëritur me lëndët irituese rrezikon të shkaktojë dermatit.

Përmban Hexamethylene diisocyanate, oligomers (isocyanurate type), hexamethylene-di-isocyanate. Mund të shkaktojë një reaksion alergjik.

SEKSIONI 12: Të dhëna ekologjike**12.1 Toksiciteti**

Emri i produktit/ ingredientit	Rezultati	Specie	Ekspozimi
Hexamethylene diisocyanate, oligomers (isocyanurate type)	Akut EC50 >1000 mg/l	Alga - scenedesmus subspicatus	72 orë
	Akut EC50 >100 mg/l	Pleshta uji - daphnia magna	48 orë
	Akut LC50 >100 mg/l	Peshq - Danio rerio (zebra fish)	96 orë
Hydrocarbons, C9, aromatics	EC50 3.2 mg/l	Pleshta uji	48 orë
	LC50 9.2 mg/l	Peshq	96 orë

Përfundim/Përmbledhje : Nuk ka të dhëna të përdorshme për përzierjen vetë.

12.2 Qëndrueshmëria dhe degradueshmëria

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 12: Të dhëna ekologjike

Emri i produktit/ ingredientit	Test	Rezultati	Doza	Inokulanti
Hydrocarbons, C9, aromatics	-	75 % - Lehtësisht - 28 ditë	-	-

Përfundim/Përmbledhje : Nuk ka të dhëna të përdorshme për përzjerjen vetë.

Emri i produktit/ingredientit	Gjysmë-jeta ujore	Fotolizë	Biodegradueshmëria
Hexamethylene diisocyanate, oligomers (isocyanurate type)	-	-	Jo menjëherë
Hydrocarbons, C9, aromatics	-	-	Lehtësisht

12.3 Potenciali biogrumbullues

Emri i produktit/ ingredientit	LogP _{ow}	BCF	Potenciali
Hexamethylene diisocyanate, oligomers (isocyanurate type)	-	3.2	e ulët
n-butyl acetate	1.78	-	e ulët
hexamethylene-di-isocyanate	1.08	-	e ulët

12.4 Lëvizshmëria në dhéKoeficient i përndarjes dhé/ ujë (K_{oc}) : Nuk zotërohet.

Lëvizshmëria : Nuk zotërohet.

12.5 Rezultatet e vlerësimit PBT dhe vPvB

PBT : Nuk zbatohet.

vPvB : Nuk zbatohet.

12.6 Efekte të tjera të padëshirueshme : Nuk dihet të ketë efekte të rëndësishme ose rreziqe të mëdha.

SEKSIONI 13: Konsiderata për eliminimin

Informacioni në këtë seksion përmban këshilla dhe udhëzime të përgjithshme. Për çdo informacion specifik ndaj një përdorimi që ofrohet në Skenarin/et e Ekspozimit, duhet këshilluar Lista e Përdorimeve të Identifikuara në Seksionin 1.

13.1 Metoda të trajtimit të mbetjeve**Produkti**

Metoda të eliminimit : Përftimi i mbetjeve duhet shmangur ose minimizuar kudo ku të jetë e mundshme. Hedhja e këtij produkti, tretësirave dhe nënprodukteve gjithnjë duhet të përmbushë kërkesat e ligjshmërisë për mbrojtjen e mjedisit dhe hedhjen e rregullt të mbetjeve, si dhe kërkesat e autoriteteve rajonale-vendore. Produktet që teprojnë e që nuk mund të riciklohen duhen eliminuar nëpërmjet një kontraktori të licencuar për eliminimin e mbetjeve. Mbetje nuk duhet eliminuar të patrajtuar nëpërmjet ujërave të zeza, veç në qoftë se kjo bëhet në pëputhje të plotë me kërkesat e të gjitha pushteteve në fuqi.

Mbetje e rrezikshme : Po.**Katalogu evropian i mbetjeve (EWC)**

Kodi i mbetjes	Emërtesa e mbetjes
08 01 11*	waste paint and varnish containing organic solvents or other hazardous substances

Ambalazhimi

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 13: Konsiderata për eliminimin

Metoda të eliminimit : Përftimi i mbetjeve duhet shmangur ose minimizuar kudo ku të jetë e mundur. Materialet e paketimit duhen ricikluar. Shkrumbimi ose dhë-mbushja duhen marrë në konsideratë vetëm kur riciklimi nuk mund të kryhet.

Lloji i paketimit	Katalogu evropian i mbetjeve (EWC)
Enë	15 01 06 mixed packaging

Masa mbrojtëse të posaçme : Ky material dhe ena përkatëse duhen eliminuar në mënyrë të sigurt. Duhet treguar kujdes kur trajtohen enë të zbrazura që nuk janë pastruar ose shpëlarë paraprakisht. Kontejnerët e zbrazur ose guarnicionet mund të kenë ruajtur ndonjë mbeturinë të produktit. Avulli nga mbeturinat e produktit mund të krijojë atmosferë tepër të ndezshme ose shpërthyes brenda në enë. Mos prisni, saldoni ose grini enët e përdorura, në qoftë se nuk i keni pastruar tërësisht nga brenda më parë. Shmangni përhapjen e materialit të derdhur, rrjedhjen dhe kontaktin me dheun, vijat ujore, kanalet shkarkuese dhe kanalet e ujërave të zeza.

14. Të dhëna për transportin

	ADR/RID	ADN (Ligji Gjerman i Transportit të Brendshëm Ujor)	IMDG	IATA
14.1 Numri UN (Kombet e Bashkuara)	UN1263	UN1263	UN1263	UN1263
14.2 Emri i përshtatshëm për transportim KB (UN)	PAINT	PAINT	PAINT	PAINT
14.3 Klasa(t) e rrezikshmërisë për transport	3	3	3	3
14.4 Grupi i ambalazhimit	III	III	III	III
14.5 Rrezikshmëri mjedisore Lëndë ndotëse të deteve	Jo. Nuk zbatohet.	Po. Nuk zbatohet.	No. Not applicable.	No. Not applicable.

Të dhëna të mëtejshme

ADR/RID : Ky lëng viskoz i kategorisë 3 nuk i nënshtrohet rregullores për paketimet deri në 450 l sipas 2.2.3.1.5.1.

Kodi i tunelit : (D/E)

ADN (Ligji Gjerman i Transportit të Brendshëm Ujor) : Produkti rregullohet si lëndë e rrezikshme për mjedisin vetëm kur transportohet me autobus. Ky lëng viskoz i kategorisë 3 nuk i nënshtrohet rregullores për paketimet deri në 450 l sipas 2.2.3.1.5.1.

IMDG : Ky lëng viskoz i kategorisë 3 nuk i nënshtrohet rregullores për paketimet deri në 30 l sipas 2.3.2.5.

IATA : Asnjë nuk identifikohet.

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

14. Të dhëna për transportin

14.6 Masa parambrojtëse të posaçme për përdoruesin : **Transporti brenda mjediseve të përdoruesit:** gjithnjë transportojeni në enë të mbyllur, në pozicion vertikal dhe të siguruar. Sigurohuni që personat që po transportojnë produktin dinë si të veprojnë në rast aksidenti ose derdhjeje.

14.7 Transportim masiv sipas Aneksit II të MARPOL dhe Kodit IBC : Nuk zbatohet.

SEKSIONI 15: Të dhëna rregullatore

15.1 Rregulloret/legjislacioni i sigurisë, shëndetit dhe mjedisit i posaçëm për lëndën ose përzierjen Rregullorja BE (EC) Nr. 1907/2006 (REACH)

Aneksi XIV – Lista e lëndëve që kërkojnë autorizim

Aneksi XIV

Asnjë nga përbërësit nuk është i listuar.

Lëndë jashtëzakonisht shqetësuese

Asnjë nga përbërësit nuk është i listuar.

Aneksi XVII – Kufizime në prodhimin, hedhjen në treg dhe përdorimin e disa lëndëve, përzierjeve dhe artikujve të rrezikshëm : Nuk zbatohet.

Rregullore të tjera BE

Ozone depleting substances (1005/2009/EU)

I palistuar.

Direktiva Seveso

Ky produkt kontrollohet nga Direktiva Seveso.

Kriteret e rrezikut

Kategoria

P5c

15.2 Vlerësimi i Sigurisë Kimike : Nuk është kryer ndonjë Vlerësim i Sigurisë Kimike.

SEKSIONI 16: Të dhëna të tjera

✔ Tregon të dhëna që kanë ndryshuar në krahasim me versionin e botuar më parë.

Shkurtime dhe akronime

ATE = Vlerësimi paraprak i Toksicitetit Akut

CLP = Rregullore Klasifikimi, Etiketimi dhe Ambalazhimi [Rregullore (EC) Nr. 1272/2008]

DNEL = Niveli i Derivuar Pa Efekt

Njoftimi EUH = njoftimi i Rrezikshmërisë specifik për CLP

PNEC = Koncentrimi i Parashikuar Pa Efekt

RRN = Numër Regjistrimi REACH

PBT = Vazhdueshëm, Biogrumbullues dhe Toksik

vPvB = Shumë i Vazhdueshëm dhe Shumë Biogrumbullues

ADR = Marrëveshja Evropiane lidhur me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me Vija Rrugore

ADN = Dispozita Evropiane lidhur me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me Vija Ujore të Brendshme

IMDG = Mallra të Rrezikshme Detare Ndërkombëtare

IATA = Shoqata e Transportit Ajror Ndërkombëtar

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 16: Të dhëna të tjera[Procedura e përdorur për të derivuar klasifikimin sipas Rregullores \(EC\) No. 1272/2008 \[CLP/GHS\]](#)

Klasifikimi	Justifikimi
Flam. Liq. 3, H226 Acute Tox. 4, H332 Skin Sens. 1, H317 STOT SE 3, H335 Aquatic Chronic 3, H412	Në bazë të dhënash nga teste Metoda e llogaritjes Metoda e llogaritjes Metoda e llogaritjes Metoda e llogaritjes

Teksti i plotë i deklaratave H të shkurtuara

H226 H302 H304	Lëng dhe avull të ndezshëm. E dëmshme në qoftë se gëlltitet. Mund të jetë vdekjeprurëse po të gëlltitet dhe të depërtojë në rrugët e frymëmarrjes.
H315 H317 H319	Shkakton iritrim të lëkurës. Mund të shkaktojë një reaksion alergjik të lëkurës. Shkakton iritrim serioz të syve.
H330 H332 H334	Vdekjeprurëse po të frymëthihet. E dëmshme po të frymëthihet. Po të frymëthihet, mund të shkaktojë simptoma alergjike ose astmatike, ose vështirësi në frymëmarrje.
H335 H336 H411 H412	Mund të shkaktojë iritrim të rrugëve të frymëmarrjes. Mund të shkaktojë përgjumje ose marramendje. Toksike për gjallesat ujore me efekte afatgjata. E dëmshme për gjallesat ujore me efekte afatgjata.

Teksti i plotë i klasifikimeve [CLP/GHS]

Acute Tox. 1, H330 Acute Tox. 4, H302 Acute Tox. 4, H332 Aquatic Chronic 2, H411 Aquatic Chronic 3, H412 Asp. Tox. 1, H304 EUH066	TOKSICITETI AKUT (frymëthihje) - Kategoria 1 TOKSICITETI AKUT (gojor) - Kategoria 4 TOKSICITETI AKUT (frymëthihje) - Kategoria 4 RREZIKSHMËRIA UJORE (AFATGJATË) - Kategoria 2 RREZIKSHMËRIA UJORE (AFATGJATË) - Kategoria 3 RREZIKSHMËRIA NË RAST ASPIRIMI/THITHJEJE - Kategoria 1 Ekspozimi i përsëritur mund të shkaktojë tharje ose plasaritje të lëkurës.
Eye Irrit. 2, H319 Flam. Liq. 3, H226 Resp. Sens. 1, H334 Skin Irrit. 2, H315 Skin Sens. 1, H317 STOT SE 3, H335	DËMTIM I RËNDË/IRRITIM I SYVE - Kategoria 2 LËNGJE TË NDEZSHME - Kategoria 3 PËRNDJESHMIM I RRUGËVE TË FRYMËMARRJES - Kategoria 1 GËRRYERJE/IRRITIM I LËKURËS - Kategoria 2 PËRNDJESHMIM I LËKURËS - Kategoria 1 TOKSICITETI SPECIFIK PËR ORGANIN E SHËNJESTRUAR (NJË EKSPOZIM I VETËM) (Irritimi i rrugëve të frymëmarrjes) - Kategoria 3
STOT SE 3, H336	TOKSICITETI SPECIFIK PËR ORGANIN E SHËNJESTRUAR (NJË EKSPOZIM I VETËM) (Efekte narkotike) - Kategoria 3

Historia

Data e botimit/ Data e ndryshimit : 27 Dhjetor 2018

Data e botimit të mëparshëm : 6 Nëntor 2018

Përgatitur nga : EHS

Versioni : 3.04

Shpërnjohe

Kodi : 00383320

Data e botimit/Data e ndryshimit

: 27 Dhjetor 2018

SIGMAFAST 210 HS HARDENER

SEKSIONI 16: Të dhëna të tjera

Informacion që gjendet në këtë fletë të të dhënave është i bazuar në njohuritë e sotme shkencore dhe teknike. Qëllimi i këtij informacioni është të tërheqë vëmendjen ndaj aspekteve të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me produktet e furnizuara prej nesh, dhe të rekomandojë masat paraprake për ruajtjen dhe trajtimin e produkteve. Nuk ka garanci dhe nuk jepet e tillë në lidhje me vetitë e produkteve. Asnjë përgjegjësi nuk mund të pranohet për çdo dështim për marrjen e masave parandaluese të përshkruara në këtë fletë të dhënave apo për ndonjë keqpërdorim të produkteve.